

Vendimet e marra në mbledhjen plenare të datës 11 Tetor 2019

POSTED 11/10/2019 KLP



Është zhvilluar sot në sallën e mbledhjeve të Prokurorisë së Përgjithshme seanca plenare e radhës e Këshillit të Lartë të Prokurorisë me rendin e ditës të dakortësuar paraprakisht me anëtarët të Këshillit. Seanca është mbajtur në prezencë të 10 anëtarëve.

Kreu i KLP-së, Gent Ibrahimimi tha para mediave prezente në nisjen e seancës se procesi i për zgjedhjen e kandidatëve për prokuror të përgjithshëm është pezulluar momentalisht. Kjo për shkak të ankimit të vendimit të Këshillit në lidhje me skualifikimin e kandidatit Lulzim Alushaj. Deri në shqyrtimin e këtij ankimi, Këshilli përgatitet për procesin e vlerësimit të pikëzimit.

“Jemi në një fazë të avancuar të procesit për zgjedhjen e kandidatëve për prokuror të përgjithshëm. Procesi është pezulluar për shkak të ankimit të vendimit të Këshillit në lidhje me skualifikimin e një kandidati. Deri në pritje të shqyrtimit të ankimit, Këshilli përgatitet për fillimin e procesit të vlerësimit dhe pikëzimit dhe kjo metodologji i shërben këtij procesi”.

Pika e parë e axhendës ishte miratimi i *Metodologjisë për vlerësimin dhe caktimin e pikëve për renditjen e kandidatëve për Prokuror të Përgjithshëm*. Metodologjia e pikëzimit të kandidatëve buron nga Ligji 115/2016 “Për organet e qeverisjes në sistemin e drejtësisë” dhe nga “Rregullorja për Prokurorin e Përgjithshëm”. Në zbatim të ligjit nr.97/2016” Për organizimin dhe funksionimin të Prokurorisë në Republikën e Shqipërisë”, neni 24,25,26 dhe 27 parashikojnë kriteret mbas të cilave vlerësohen kandidatët: kriteret profesionale, kriteret morale, kriteret organizative dhe drejtuese dhe elemente plotësuese vlerësimit (tituj akademik, trajnime afatgjata, gjuhë të huaja. Pas bisedimeve, Këshilli vendosi se miratimi i kësaj metodologjie do të kalojë për mbledhjen e ardhshme në mënyrë që të reflektohen në variantin përfundimtar disa ndryshime dhe përcaktime të bëra nga anëtarët të Këshillit gjatë diskutimeve.

Gjatë mbledhjes janë miratuar miratuar dy raportet për *Analizimin e aftësive profesionale të subjektet të rivlerësimit kalimtar*, prokuror Kujtim Luli dhe prokuror Gent Xholi. Këto raporte do t'iu vihet menjëherë në dispozicion organeve të vetingut.

Me shumicë votash, Këshilli i Lartë i Lartë i Prokurorisë ka miratuar *Raportet të verifikimit të pasurisë dhe figurës dhe lista pjesore për 12 kandidatë të pranuar në formimin fillestar në Shkollën e Magjistraturës; Ndriçim Halilaj, Iva Harka, Fjorda Shqarri, Entela Hasmujaj, Esmeranda Basho, Denisa Plaku, Besmira Vishe, Redona Ndoni, Albulena Kulici, Vasjana Postol, Alban Syri, Ledjana Shkurti*. Më herët ishin skanuar vetën 4 kandidatë, nga shifrav totale prej 23.

Gjatë fjalës së tij, kryetari i KLP-së, Gent Ibrahimimi nënvizoi se *“Ligjet e reja në kuadër të të cilave vepron këshilli, por edhe sistemi i drejtësisë në përgjithësi, diktojnë që edhe kandidatët që pranohen për të ndjekur Shkollën e Magjistraturës para se të fillojnë studimet duhet të vetohen nga ana e Këshillit të Lartë të Prokurorisë. Ky është një proces që Këshilli e merr shumë seriozisht.”*

Mbledhja ka vijuar me pikat e tjera të rendit të ditës, ku është miratuar me 9 vota pro (anëtarja e Këshillit, Nurihan Seiti nuk ishte prezente në sallë gjatë momentit të votimit) projekt aktit për caktimin në detyrë të prokurores Edlira Bako në Prokurorinë e Shkallës së Parë Elbasan. Gjithashtu me 8 vota pro dhe 2 kundër (anëtarët Bujar Sheshi dhe Kostaq Beluri) është miratuar projekt aktit për caktimin në detyrë të prokurores Pranvera Gruda në Prokurorinë e Shkallës së Parë Durrës. Me shumicë votash u miratua projekt aktit për caktimin e përkohshëm të prokurorit Gjon Fusha si Drejtues në Prokurorinë e Shkallës së Parë Gjirokastër.